

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatorë Ekonomik: Pro Tech Clean SHPK me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi , Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	25.08.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **22.08.2025**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Pro Tech Clean SHPK** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës**, me Numër të prokurimit: **623-25-6580-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-045-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Pro Tech Clean SHPK** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës**, me Numër të prokurimit: **623-25-6580-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-045-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **24.07.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës**, me Numër të prokurimit: **623-25-6580-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-045-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Pro Tech Clean SHPK** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës**, me Numër të prokurimit: **623-25-6580-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-045-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **24.07.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **22.08.2025**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE E KËRKESËS

Pretendimi nr.1

Sa i përket kriterit për qarkullimin financiar minimal prej 310,000 € për secilin Lot, ne e konsiderojmë këtë kërkesë në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik. Mirëpo, ju si kufizimim keni vendosur për konsorciumet, ku kërkohet që lideri i konsorciumit të ketë detyrimisht 60% të qarkullimit financiar.

Ky kufizim, sipas LPP-se, është i padrejtë dhe diskriminues, për arsye se bie ndesh me frymën e nenit 28 dhe nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042, të cilat përcaktojnë se kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë proporcionale, të lidhura me objektin e kontratës dhe të mos kufizojnë konkurrencën në mënyrë të panevojshme.

Ligji njeh të drejtën e operatorëve ekonomikë që të paraqesin ofertë në formë të konsorciumit, dhe që secili anëtar kontribuon me kapacitetet e veta financiare, teknike dhe profesionale për të përmbushur së bashku kriteret e kërkuara. Duke vendosur që vetëm lideri i konsorciumit duhet të ketë 60% të qarkullimit, Autoriteti Kontraktues në fakt po kufizon në mënyrë artificiale mundësinë e bashkëpunimit të barabartë midis operatorëve ekonomikë.

Kerkojme nga AK që ky kriter të rishqyrtohet dhe të largohet kufizimi prej 60%.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Lidhur me **Pretendimin nr. 1** të Operatorit Ekonomik ankues, i cili ka theksuar se kriteri për qarkullimin financiar minimal prej 310,000 € për secilin Lot, si dhe kërkesa që lideri i konsorciumit të ketë së paku 60% të këtij qarkullimi, është diskriminuese dhe bie ndesh me nenin 28 dhe nenin 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, sqarojmë si në vijim:

Ky pretendim është **i pabazuar**. Autoriteti kontraktues, gjatë hartimit të Dosjes së Tenderit, ka vepruar në përputhje të plotë me **RREGULLOREN Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (Versioni i Konsoliduar)**. Konkretisht, **Neni 26 (Grup i Operatorëve Ekonomik), pika 26.10**, përcakton qartë:

“Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-së, ku AK-të mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga lideri i grupit të OE-ve.”

Në këtë rast, autoriteti kontraktues ka vlerësuar si **të domosdoshme dhe proporcionale** përcaktimin që lideri i konsorciumit të mbajë minimum 60% të qarkullimit financiar të kërkuar, për të siguruar stabilitet financiar dhe përgjegjësi kryesore në ekzekutimin e kontratës.

Prandaj, **autoriteti kontraktues ka të drejtë ligjore të përcaktojë një përqindje minimale për liderin e konsorciumit**, dhe ky kufizim nuk është as diskriminues dhe as i paarsyeshëm, por i bazuar në rregullore dhe në parimin e proporcionalitetit.

Pretendimi nr.2

Sa i përket kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit që Operatori Ekonomik të dëshmojë përvojë me kontrata të përfunduara me sukses gjatë tre viteve të fundit në vlerë prej 232,000.00 € për secilin Lot, vlerësojmë se kërkesa për përvojë të mëparshme është në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik. Mirëpo, vërejtja jonë kryesore lidhet me kufizimin e vendosur për konsorciumet, ku përcaktohet që lideri duhet të ketë patjetër 60% të kësaj vlere.

Ky kufizim është i panevojshëm dhe bie ndesh me nenin 28 të Ligjit Nr. 04/L-042, i cili përcakton se kriteret për përzgjedhje duhet të jenë proporcionale me natyrën e kontratës, të mos krijojnë pengesa të panevojshme dhe të garantojnë konkurrencë reale.

Po ashtu, sipas nenit 59 të LPP-së, operatorët ekonomikë të paraqitur në formë të grupit (konsorciumit) lejohen të kombinojnë kapacitetet e tyre teknike dhe profesionale për të përmbushur kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Ligji nuk parasheh kufizime të tilla ku njëri anëtar (lideri) duhet të mbajë mbi vete 60% të përvojës së kërkuar. Një kërkesë e tillë është disproporcionale dhe në fakt eliminon mundësinë që operatorët e mesëm dhe të vegjël të bashkëpunojnë në formë konsorciumi për të konkurruar me sukses në këtë aktivitet të prokurimit.

Në praktikë, mjafton që konsorciumi si njësi e përbashkët të demonstrojë përvojën e kërkuar, pavarësisht shpërndarjes së saj midis anëtarëve. Imponimi i përqindjes 60% për liderin nuk është i bazuar në LPP dhe krijon barrierë artificiale ndaj konkurrencës.

Kerkojme nga AK që ky kriter të rishqyrtohet dhe të largohet kufizimi prej 60%.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Sa i përket **Pretendimit nr. 2** të operatorit ekonomik ankues, i cili pretendon se kërkesa në Dosjen e Tenderit që lideri i konsorciumit të dëshmojë minimum 60% të vlerës së përvojës së mëparshme prej 232,000.00 € për secilin Lot është diskriminuese dhe bie ndesh me nenin 28 dhe nenin 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, sqarojmë si në vijim:

Ky pretendim është **i pabazuar**. Autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me **RREGULLOREN Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (Versioni i Konsoliduar)**, ku **Neni 26 (Grup i Operatorëve Ekonomik)**, **pika 26.10**, përcakton:

“Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-së, ku AK-të mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga lideri i grupit të OE-ve.”

Bazuar në këtë dispozitë, autoriteti kontraktues ka të drejtë ligjore të përcaktojë që lideri i konsorciumit të dëshmojë një pjesë të konsiderueshme të përvojës së kërkuar. Vendosja e pragut prej 60% është bërë duke respektuar parimin e proporcionalitetit, duke qenë se lideri është bartësi kryesor i përgjegjësisë për realizimin e kontratës.

Në këtë mënyrë, nuk ka shkelje të LPP-së dhe as kufizim artificial të konkurrencës, por përkundrazi sigurohet që kontrata të ekzekutohet nga një operator me kapacitet të mjaftueshëm dhe të dëshmuar profesional.

Pretendimi nr.3

Sa i përket kërkesës së vendosur në Dosjen e Tenderit që operatorët ekonomikë, së bashku me ofertë, duhet të dorëzojnë mostrat e materialeve të përcaktuara, 60 minuta para hapjes së ofertave, konsiderojmë se ky kriter është i panevojshëm dhe i kundërligjshëm, pasi bie ndesh me frymën dhe parimet themelore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Sipas nenit 7 të LPP-së, prokurimi publik duhet të bazohet në trajtim të barabartë, konkurrencë të lirë dhe proporcionalitet. Dorëzimi i mostrave para hapjes së ofertave rrezikon seriozisht këto parime, për shkak se:

1. Krijon rrezik të identifikimit të operatorit ekonomik përmes mostrave, pavarësisht përpjekjeve për eliminim të shenjave, duke rritur kështu mundësinë e njëanshmërisë ose favorizimit në procesin e vlerësimit.
2. Mostrat, sipas praktikës së mirë të prokurimit, kërkohen në fazën e vlerësimit të ofertës teknike, pasi të jetë bërë hapja dhe regjistrimi i ofertave, për të mos ndikuar në procesin e hapjes së tyre. Ky është edhe interpretimi më i drejtë i nenit 37 të Rregullores Nr. 001/2022, i cili nuk e obligon dorëzimin e mostrave para hapjes, por e lë këtë në kompetencë të fazës së vlerësimit.
3. Një kusht i tillë i vendosur para hapjes së ofertave është i tepruar me natyrën e kontratës, duke krijuar barrë shtesë dhe pengesa për operatorët ekonomikë që mund të kenë vështirësi logjistike në dorëzimin e mostrave në atë formë dhe afat të shkurtër.

Andaj ne si OE kërkojmë nga ju si AK që ky kriter të hiqet nga dosja e tenderit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Sa i përket **Pretendimit nr. 3** të operatorit ekonomik ankues, ku theksohet se kërkesa për dorëzimin e mostrave të materialeve të përcaktuara 60 minuta para hapjes së ofertave është e panevojshme dhe e kundërligjshme, sqarojmë si në vijim:

Ky pretendim është **i pabazuar**. Autoriteti kontraktues ka vepruar në përputhje të plotë me **RREGULLOREN Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (Versioni i Konsoliduar)**, ku **Neni 37** përcakton qartë:

“Autoritetet kontraktuese, në rastet kur kërkojnë mostra, mund të përcaktojnë mënyrën, kohën dhe vendin e dorëzimit të tyre, duke siguruar se mostrat nuk përmbajnë shenja identifikuese të operatorëve ekonomikë, me qëllim të shmangies së çdo mundësie për njëanshmëri në procesin e vlerësimit.”

Në këtë kuadër, autoriteti kontraktues ka përcaktuar dorëzimin e mostrave **60 minuta para hapjes së ofertave**, duke respektuar dispozitat e mësipërme dhe duke garantuar që:

Mostrat të jenë të dorëzuara në mënyrë të barabartë nga të gjithë operatorët;

Të eliminohet çdo shenjë identifikuese, siç është paraparë në dosjen e tenderit;

Të sigurohet integriteti dhe paanshmëria e procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

Prandaj, kërkesa e autoritetit kontraktues është **e ligjshme, proporcionale dhe e arsyeshme**, në përputhje me nenin 7 të LPP-së (parimi i barazisë dhe konkurrencës së lirë) dhe nenin 37 të Rregullores Nr. 001/2022. Vendosja e këtij afati nuk krijon as pengesë artificiale dhe as diskriminim, por shërben për të rritur transparencën dhe për të shmangur çdo mundësi të favorizimit.

Pretendimi i operatorit ekonomik refuzohet si **i pabazuar dhe i paarsyeshëm**, ndërsa kërkesa për dorëzimin e mostrave 60 minuta para hapjes së ofertave mbetet në fuqi.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>